



BASHKIA VLORE – DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Rehabilitimi dhe riasfaltimi i disa akseve kryesore te qytetit te Vlores

RELACION PERSHKRIMI

Open
Procurement
Albania

RELACION PERSHKRIMI

Ne kete projekt parashikohen nderhyrje siperfaqesore dhe riparimi ne nje pjese te akseve kryesore te qytetit te Vlores dhe perkatesisht: Rruga Nacionale Vlore-Fier, rruga Jani Gjoncari, rruga Tasim Rakipi, rruga Liria, blloku i banimit ne jug te shkolles Industriale, rruga Mis Durhan, rruga Fan Noli, blloku i banimit tek pallatet e Gorishtit, sistemimi i qendres se fshatit Llakatund, sistemimi i rruges se fshatit Bestrove, sistemimi i qendres se fshatit Tre-vellazer, rruga Drashovica, rruga e fshatit Xhyherine, hapësira ne rrugen Kastriot Gjini, rruga Anita Bitri, rruga Laze Malo, etj

Per sa i perket rrugeve te tjera te pa permendura ne kete projekt si Zenel Gjoleka apo akse te tjera midis atyre ne projekt, ato jane ne projekte paralele ne faze financimi nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

NDËRHYRJET E PARASHIKUARA

Për realizimin e këtij projekti janë kryer studime ne terren te gjendjes se çdo rruge gjate gjithë gjatësisë se tyre. Nderhyrje te vazhdueshme për shtrirje kanalizimesh si dhe një periudhe e gjate ne mungese te një mirëmbajtje te plote dhe te kujdesshme ka çuar ne një gjendje ku nevojiten ndërhyrje te menjëhershme. Këto ndërhyrje duhet te jene pikëlore për riparimin e dëmtimeve te lokalizuara si dhe te përgjithshme për ripërtëritjen e pjesës sipërfaqesore.

Nderhyrja e përgjithshme do te konsistojë ne sakrifikimin dhe riasfaltimin e gjithë gjatësisë se rrugës si dhe rindërtimi i pendencave për heqjen e ujit nepermjet shtresës se binderit ne pjeset ku këto pendenca mungojnë.

Një pjese e rrugëve shfaqin edhe dëmtime lokale si gropa apo çarje pergjat trupit. Për ketë arsye do te karikohet rruga atje ku te jete e nevojeshme me cakell te holle lavatriceje dhe do te priten ato pjese qe jane demtuar me shume per te aplikuar shtresat e duhura te rruges sipas KTZ se rrugeve:

- shtrese binderi deri 6-4 cm
- shtrese asfalto betoni 4 cm.

Konfigurimi i rruges do te behet me trashësi 6 cm ne pjesën me kuote me te larte dhe 4 cm nga ana e kunetës. Gjithashtu është parashikuar dhe rikonstruksioni i kunetës ne pjesët ku ato janë te dëmtuara si dhe ngritja e pusetave ekzistuese ne nivelin e asfaltit te ri.

PROJEKTI

Projekti parashikon riasfaltimin e plote te te gjitha rrugëve dhe riparimi i demeve te lokalizuara. Nje ndërhyrje tjeter do te jete konfigurimi i pjerrësisë se rrugëve qe kane humbur atë me trashësi 6 cm ne pjesën me kuote me te larte dhe 4 cm nga ana e kunetes.

Do te meren masa per largimin e plote te ujrave duke vene ne funksion pusetat e grumbullimit te ujrave siperfaqesore dhe kunetat e betonit. Asfaltimi do te kryhet ne kohe te thate dhe konform KTZ se asfaltimit te rrugeve.

Nuk do te kete ndryshime ne gjeometrine e rrugeve (ne profilet terthor apo gjatesor) apo ne drejtimet, llojet e trafikut dhe sinjalistike. Ne kete projekt eshte parashikuar vetem riparimi dhe zevendesimi i shtresave te demtuara te rrugeve.

SHTRESAT RRUGORE

Projekti trajton vetëm rruge ekzistuese dhe për këtë shtresat qe do te perdoren per riparimin e rrugës do te jene te njëjta me pjesën tjetër te rrugës. Gjithashtu ne rruget ekzistuese do te behet plotesimi i shtresave ekzistuese me shtresat e tjera te nevojeshme.

ORGANIZIMI I PUNIMEVE

Per rikonstrukcionin e rruges eshte parashikuar qe materialet e ndertimit do te prodhohen me gur kave qe gjendet ne guroret e rrethit . Materiali i asfalto betonit do te vije i gatshem nga nyjet me te aferta ne perputhje me kerkesat e projektit.

Te gjitha punimet jane parashikuar te kryhen ne perputhje me specifikimet teknike qe i bashkëngjiten këtij projekti.

Preventivi i punimeve eshte dhene për te gjithë rrugët dhe janë parashikuar te gjithë zerat e punimeve sipas specifikimeve teknike te keti projekti, me çmimet e Manualit te Punëve Publike, per vitin 2015.

Per te gjitha zerat e punimeve jane bere analizat e prodhimit dhe vendosjes ne veper ne perputhje me organizimin e punimeve, standartet dhe kushtet teknike ne fuqi.

Bashkëngjitur këtij raporti janë dhene; specifikimet teknike te punimeve, volumet e punimeve me vleresimet e kostos, dhe preventivi perkates

Situacionimi i këtyre punimeve do te behen mbas verifikimit dhe matjes se punimit ne proces verbalin e vecante qe do te hartohet nga drejtuesi i punimeve , kontraktori dhe drejtuesi teknik i Ndermarrjes se Sherbimeve

PERSHKRIMI I NDERHYRJEVE

1. Rruga Nacionale Vlore-Fier(hyrja e qytetit-pusi i mezinis)

Kjo rrugë është në një gjendje të demtuar dhe nevojitet një ndërhyrje imediate mirëmbajtje. Nga një studim i realizuar nga grupi i punës në vend është vërejtur se nevojitet të ndërhyhet në:

- Mbushja e disa gropave
- Riasfaltimi dhe vijëzimi i rrugës.
- Riparim i pjesëshëm i kurbës nga ana e trotuarit ekzistues



2. Rruga "Nikolla XHuveli"

Kjo rrugë është në një gjendje tepër të amortizuar dhe ka nevojë për ndërhyrje urgjente për riparimin e shtresave dhe të gropave ekzistuese. Nderhyrjet përgjatë kësaj rrugë janë si më poshtë:

- Mbushja e disa gropave dhe rikonstruksioni i shtresave të demtuara
- Riasfaltimi dhe vijëzimi i rrugës.
- Riparim të kurbave nga ana e trotuarit ekzistues



3. Rruga ``Jani Gjoncari`` (mbrapa lulishtes se Sheshit te Flamurit)

Kjo rruge është ne një gjendje teper te amortizuar dhe ka nevojë per nderhyrje urgjente per riparimin e shtresave dhe te gropave ekzistuese. Nderhyrjet pergjate kesaj rruge jane si me poshte:

- Mbushja e disa gropave dhe rikonstruksioni i shtresave te demtuara
- Riasfaltimi dhe vijezimi i rruges.
- Riparim te kunetave nga ana e trotuarit ekzistues



4. Rruga ``Tasim Rakipi``, ``Mulla Xhaferri``

Kjo rruge është ne një gjendje relativisht te dëmtuar dhe paraqet një nevojë për ndërhyrje te menjëhershme riparimi. Nga një studim i realizuar nga grupi i punës ne vend është vërejtur se nevojitet te ndërhyhet ne:

- Mbushja e disa gropave dhe rikonstruksioni i shtresave te demtuara
- Riasfaltimi dhe vijezimi i rruges.
- Riparim te kunetave nga ana e trotuarit ekzistues

5. Rruga Liria (mbrapa Holyday)

Kjo rrugë është në një gjendje relativisht të dëmtuar dhe paraqet një nevojë për ndërhyrje të menjëhershme riparimi. Nga një studim i realizuar nga grupi i punës në vend është vërejtur se nevojitet të ndërhyhet në:

- Mbushja e disa gropave dhe rikonstrukcioni i shtresave të dëmtuara
- Riasfaltimi dhe vijëzimi i rrugës.
- Riparim të kuletave nga ana e trotuarit ekzistues

